



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI



Tiranë, më \_\_\_\_\_ 2020

**KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE,  
ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT**

*Në vëmendje të:*

Kryetarit, **Z. Ulsi Manja**  
Deputetëve, Anëtarë të Komisionit

**Objekti:** *Propozime për amendamente në projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, nismë e deputeteve Eglantina Gjermeni dhe Klotilda Bushka*

I nderuar Z.Manja,

Të nderuar Kolegë Deputetë,

Bazuar në nenin 71, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë paraqes amendamente për disa shtesa në projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nismë e deputeteve Eglantina Gjermeni dhe Klotilda Bushka:

**1. Titulli i projektligjit ndryshohet me përmbajtjen si vijon:**

“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

**2. Pas Nenit 1 të projektligjit, shtohet Neni 2 me përmbajtjen si vijon:**

**Neni 2**

Pas nenit 242, shtohen nenet 242/1 dhe 242/2 me këtë përmbajtje:

**“Neni 242/1**

**Mosbindja ndaj masave të organeve kompetente shtetërore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore**

Mosbindja ndaj rregullave, vendimeve dhe urdhrave të nxjerra nga organet kompetente shtetërore për masat e marra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme apo gjendjes së fatkeqësisë natyrore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj. Po kjo veprë, e kryer në mënyrë të përsëritur dënohet me burgim nga tridhjetë ditë deri në një vit. Kur nga vepra është shkaktuar rrezikimi i jetës ose vdekja e personit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.”.

**“Neni 242/2**

**Shkelja e rregullave të karantinës për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive**

Moszbatimi i urdhrat të karantinës apo shkelja e rregullave të karantinës nga personi mbartës ose jo i sëmundjes infektive ngjitëse, përbën veprë penale dhe dënohet me gjobë dhe me burgim deri në dhjetë vjet.

Po kjo veprë, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për shëndetin ose jetën e njerëzve dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Kur nga vepra ka ardhur ose ka mundësi të vijë vdekja e personit, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”.

**3. Neni 2 i projekligjit “Hyrja në fuqi” bëhet neni 3.**

**DEPUTETE PROPOZUESE**

**Edlira BODE**



## **ARSYETIMI I AMENDAMENTEVE**

Qëllimi pse paraqes amendimet në Kodin Penal lidhet me parandalimin e përhapjes së infeksioneve dhe forcimin e luftës kundër epidemive, nisur nga situata e vështirë që po kalon vendi ynë dhe mbarë bota nga virusi COVID19.

Për të arritur këtë qëllim, përvec sanksioneve administrative për të gjithë ata persona që do të shkelnin masat e marra, të vendosura nga organet shtetërore, është e nevojshme që të parashikohen dhe sanksione në Kodin Penal, për disa veprime dhe mosveprime të caktuara, duke marrë në konsideratë rrezikun që kanoset për jetën dhe shëndetin nga përhapja e epidemive të sëmundjeve ngjitëse, apo në situata në tjera në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme apo gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Vende anëtare të Bashkimit European, ku përmend Italinë, kanë parashikuar sanksione të tilla në Kodin Penal.